




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË – KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Në bazë të Ligjit mbi Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, UA Nr.10 / 2018 dhe në bazë të nenit 8, paragrafi 1,2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, lidhur me kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së punës, Drejtori i Drejtorisë për Arsim në Fushë Kosovë shpallë:

K O N K U R S për këto vende të lira

1. **Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ Mihal Grameno “ – Fushë Kosovë**
 - Një arsimtar klasor me kohë të caktuar, deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë
2. **Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ Daut Bogujevci “ Fushë Kosovë**
 - Një arsimtar klasor me kohë të caktuar, deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë
3. **Shkolla e Mesme e Lartë “ Minatori “ Fushë Kosovë**
 - Dy inxhinjerë të elektroteknikës në kohë të caktuar, deri më 31.08.2020

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Mësim klasor në Shkollë të Mesme të Ulët:

- ☐ Fakulteti i Edukimit – programi fillor
- ☐ Fakulteti i Mësuesisë
- ☐ Sistemi katërvjeçar;
- ☐ Bachelor (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për inxhinjerë në Shkollë të Mesme të Lartë:

- ☐ Fakulteti Teknik – Master i elektroteknikës
- ☐ Fakulteti Teknik – Bachelor i elektroteknikës

Dokumentacioni i nevojshëm :

- Të jetë banor i Kosovës - letërnjoftimi
- CV
- Çertifikata e lindjes
- Diploma e fakultetit
- Vertetimi se nuk është nën hetime

Sqarim :

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, gjegjësisht , do të refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë .

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kriterë:

- Njohuritë e përgjithshme 25 pikë,
- Aftësitë e përgjithshme dhe personalitetit 35 pikë dhe
- Njohuritë profesionale 40 pikë (ku përfshihen përvoja e punës dhe nota mesatare gjatë studimeve).

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diploma të nostrifikuara nga MASHT-I .

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për testin me shkrim dhe intervistën me gojë si dhe të gjitha njoftimet tjera publikohen në Faqen Zyrtare të Komunes së FushëKosovës :
<https://kk.rks-gov.net/fushekosova/> dhe permes tel. ose e-mail –it .

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor shtator, 2019 – gusht, 2020 . Në rast të ndonjë nevojë eventuale shtesë për mësimdhënës/e në institucione shkollore, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave prioritare me rastin e shpalljes së rezultateve. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati i konkursit është 15 ditë prej datës së shpalljes .

Dokumentacioni komplet dorëzohet në Arkivin e Komunes në katin përdhësë , në ndërtesën e Komunes së Fushë Kosovës .

Adresa : rruga e Pejës , p.n . - Fushë Kosovë

